

VENDIM I KËSHILLIT SHKENCOR

Nr. 1, dt. 19.01.2016

Mbështetur në Vendimin nr. 45, dt. 22.07.2014 të KKR, ku citohet se *“Miratimi i projekteve për punime rutinë mirëmbajtjeje të bëhet nga Këshilli Shkencor, pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës”*, si dhe vendimin nr.116, dt. 01.06.2015 ku citohet se *“Projektet sipas përcaktimit të Vendimin nr. 45 të KKR, dt. 22.07.2014, si dhe vendimet e Këshillit Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, të firmosen nga Sekretari i Këshillit Kombëtar të Restaurimeve, i cili mban njëkohësisht dhe funksionin e Kryetarit të Këshillit Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës”*, Këshilli Shkencor i IMK, në mbledhjen e dt. 19.01.2016, pasi shqyrtoi projektin për realizimin e disa punimeve në apartamentin e z. Shpëtim Caushaj, vendosi:

- *Miratimin e projektit për ndërhyrjet restauruese në apartamentin në rrugën “Bajram Curri”, Pallati 85, Apartamenti 2, Shkalla 1, Tiranë, me pronar z. Shpëtim Caushi.*

Ngarkohet Sekretaria Teknike e KKR për njoftimin e këtij vendimi.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ARTA DOLLANI

